FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 42

Tiranë – E hënë, 3 mars 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 59, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3979
Dekret i Presidentit nr. 60, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3979
Dekret i Presidentit nr. 61, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3979
Dekret i Presidentit nr. 62, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3979
Dekret i Presidentit nr. 63, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3980
Dekret i Presidentit nr. 64, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3980
Dekret i Presidentit nr. 65, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3980
Dekret i Presidentit nr. 66, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3981
Dekret i Presidentit nr. 67, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3981
Dekret i Presidentit nr. 68, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3981
Dekret i Presidentit nr. 69, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	3982

Dekret i Presidentit nr. 70, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3982
Dekret i Presidentit nr. 71, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3982
Dekret i Presidentit nr. 72, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3982
Dekret i Presidentit nr. 73, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3983
Dekret i Presidentit nr. 74, datë 24.2.2025	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	3983
Dekret i Presidentit nr. 77, datë 25.2.2025	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	3983
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 6, datë 24.2.2025	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.....	3984
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 7, datë 21.2.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 18.7.2024, "Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për çrrënjosjen dhe parandalimin e përhapjes së *Globodera pallida* (Gurit) Behrens dhe *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens.....	3998
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 8, datë 21.2.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 23, datë 20.9.2024, për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për vendosjen e masave për çrrënjosje dhe parandalimin e përhapjes së kalbëzimit unazor të patates *Clavibacter sepedonicus* (Spieckermann & Kotthoff 1914) Nouioui *Et Al.* 2018.....	4000
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 9, datë 21.2.2025	Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda territorit të vendit të brumbullit të patates *Epitrix cucumeris* (Harris), *Epitrix similaris* (Gentner), *Epitrix subcrinita* (Lec.) dhe *Epitrix tuberis* (Gentner)	4003
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 159, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	4006
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 160, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Sllovenisë.....	4010
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 161, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	4011
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 162, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Belgjikës.....	4012
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 163, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	4013

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 165, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve të shfaqur në shtetin e Sllovenisë.....	4015
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 166, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	4016
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 167, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë....	4017
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 168, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	4018
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 169, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë.....	4018
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 170, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar.....	4019
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 171, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Moldavisë....	4020
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 172, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë.....	4020
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 173, datë 21.2.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	4021
Vendimi i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 5, datë 21.2.2025	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	4023
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nr. 474 (33-2024-1790), datë 27.11.2024	Për shpalljen të vdekur të shtetasit Sali (Mikel) Spahiu.....	4107
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nr. 458 (33-2024-1756), datë 19.11.2024	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Marisel (Florin) Nuredini.....	4107
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nr. 743 (4095), datë 14.10.2024	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Simon Ndoja.....	4108

DEKRET
Nr. 59, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Zeynep Cemil Hodo

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 60, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Kaan Petrit Kaya

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 61, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Petraq Vangjel Filari

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 62, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16 dhe 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ertigen Shkëlqim Ramaliu
2. Bedri Sherif Almeta
3. Miranda Mersin Aliko

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 63, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Gazmend Ramazan Pinjoli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 64, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Albina Shabi Limani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 65, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Emrah Hulusi Yalcin

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 66, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:
1. Iuliia Boris Khakhina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 67, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Flavio Antonio Vegetti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 68, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:
1. Turan Ahmet Yildirim

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 69, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Samir Abderrazak Boucakri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 70, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Denny David René Robby Guy Philip Francis Windmolen
2. Agim Zeqir Ramosaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 71, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Alkid Skënder Kërluku
2. Endri Skënder Kërluku

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 72, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Edmond Maksut Kapllani
2. Nejva Jani Nano

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 73, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Agim Shyqyri Ballvora
2. Ira Faslli Belliu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 74, datë 24.2.2025

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës; neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Zana Zejnelabedin Mersinaj (Dashi)
2. Adelina Enver Bejtaga
3. Malvina Halim Tabaku (Hoxha)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 77, datë 25.2.2025

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", i ndryshuar, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Deivis Petraq Shomo
2. Rigers Shefqet Halili
3. Klodian Shpetim Zeme

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM
Nr. 6, datë 24.2.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2 "Përkufizime të përgjithshme" bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 10/1 dhe 11 shfuqizohen.

b) Pika 14 riformulohet me përmbajtjen, si më poshtë:

"*14. Për qëllime të nenit 63/1 të këtij udhëzimi, kontraktori është subjekti që kontraktohet, sipas rastit, nga zbatuesi i projektit ose përfituesi i projektit (nëse nuk ka zbatues), me qëllim realizimin e projektit.".*

Neni 2

Në nenin 24 "Vendi i furnizimit të shërbimeve kundrejt një personi të tatueshëm që vepron si i tillë", pika 2, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në paragrafin e parë, togfjalëshi "*... pra marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm për TVSH-në ... sipas dispozitave të nenit 23 të ligjit për TVSH-në.*", riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

"*... pra marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm që vepron si i tillë jashtë Shqipërisë, referuar kuptimit të nocionit të personit të tatueshëm, sipas dispozitave të ligjit për TVSH-në.*".

b) Në paragrafin e dytë, hiqet togfjalëshi "*...i TVSH-së...*".

c) Shkronja "ii" ndryshohet me përmbajtjen, si më poshtë:

"*ii. Vërtetim nga autoritetet tatimore të vendit të marrësit të shërbimit ku të shprehet qartë që marrësi është person i tatueshëm i angazhuar në veprimtari ekonomike dhe numri i identifikimit të tij për qëllime fiskale, si numri i identifikimit të TVSH-së ose një numër i ngjashëm, është aktiv.*".

d) Në shkronjën "iv", pas togfjalëshit "*nr. e identifikimit të TVSH-së"* shtohet togfjalëshi "*... ose një numër i ngjashëm që tregon se marrësi i shërbimit është një person i tatueshëm ...*".

e) Në paragrafin e dytë dhe të tretë pas shkronjës "v", hiqet togfjalëshi "*... për TVSH-në ...*".

f) Në shembullin 4, kudo në përmbajtje, hiqet togfjalëshi "*... të identifikuar për TVSH-në ...*".

Neni 3

Neni 63/1, "Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit/grantit me donatorët, përveç granteve nga Bashkimi Evropian", riformulohet me përmbajtjen, si më poshtë:

"*Neni 63/1*

Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e donacionit/grantit

1. Në zbatim të shkronjës "c", të pikës 1, të nenit 60, të ligjit, për qëllime të TVSH-së, trajtohet si furnizim i ngjashëm me eksportet, furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime në Shqipëri.

2. Regjistrimi i projektit nga zbatuesi ose përfituesi (nëse nuk ka zbatues) në Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (Agjencia):

a) Regjistrimi i projektit bëhet duke paraqitur tek Agjencia Formularin e Aplikimit për Regjistrimin e Projektit, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, të nënshkruar dhe të vulosur, së bashku me dokumentacionin e cilësuar në këtë formular. Përjashtimisht, vetëm në rastet e projekteve të financuara nën instrumente të BE-së të ndryshme nga IPA III, sipas parashikimeve të pikës 2(b), të nenit 28, të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit IPA III, është i aplikueshëm dokumentacioni i referuar në pikën 2.3 të këtij formulari.

Kur zbatuesi i projektit është jorezident, regjistrimi i projektit tek Agjencia mund të bëhet nëpërmjet përfaqësuesit tatimor.

b) Agjencia vlerëson kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga zbatuesi/përfituesi (nëse nuk ka zbatues) i projektit dhe nëse është i plotë, lëshon Certifikatën e Regjistrimit të Projektit, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, Agjencia njofton zbatuesin/përfituesin (nëse nuk ka zbatues) e projektit për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda 5 (pesë) ditëve pune.

c) Certifikata e Regjistrimit të Projektit përmban elementet, si: emërtimi i projektit, data e fillimit dhe data e përfundimit të projektit, të dhënat e zbatuesit/përfituesit (nëse nuk ka zbatues) të projektit, përfshirë NIPT/NUIS, si dhe Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të lëshuar nga Agjencia për këtë qëllim.

Për çdo projekt mund të ketë vetëm një Kod Unik të Identifikimit të Projektit, pavarësisht numrit të zbatuesve/përfituesve (nëse nuk ka zbatues) të këtij projekti. Certifikatat e tjera të lëshuara nga Agjencia për të njëjtin projekt, do të përmbajnë Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, me fraksion të certifikatës së parë.

d) Agjencia, brenda 2 (dy) ditëve pune, nëpërmjet postës elektronike dhe/ose shërbimit postar rekomande, i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD), një kopje të Certifikatës së Regjistrimit të Projektit, së bashku me kopje të dokumentacionit të parashikuar në Formularin e Aplikimit.

e) Në rast të ndryshimit të kushteve të dokumentit përkatës që rregullon projektin, përfshirë vlerën e financimit, zbatuesi/përfituesi (nëse nuk ka zbatues) i projektit duhet të njoftojë Agjencinë, brenda një afati 5-ditor (pesëditor). Në këtë rast, Agjencia, brenda 2 (dy) ditëve pune, njofton nëpërmjet postës elektronike dhe/ose shërbimit postar rekomande DPT-në dhe DPD-në për ndryshimet në certifikatën e projektit.

f) DPT-ja dhe DPD-ja raportojnë në fundin e muajit pasues të çdo tremujori tek Agjencia, të dhëna të detajuara për çdo transaksion të kryer në kuadër të këtij projekti nga zbatuesi/përfituesi (nëse nuk ka zbatues) apo kontraktori (të dhëna të tilla si, NIPT/NUIS, Kodi Unik i Identifikimit të Projektit, vlera, monedha etj.).

3. Regjistrimi i projektit në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT)

DPT-ja, certifikatën e lëshuar nga Agjencia, së bashku me dokumentacionin e dërguar sipas shkronjës "d", të pikës 2, më sipër, ia përcjell brenda 5 (pesë) ditëve pune, DRT-së ku është i regjistruar zbatuesi/përfituesi (nëse nuk ka zbatues) i projektit.

I. Kur zbatuesi/përfituesi (nëse nuk ka zbatues) e zbaton vetë projektin, DRT-ja përkatëse regjistron në një regjistër të veçantë zbatuesin/përfituesin e projektit, si dhe brenda 5 (pesë) ditëve pune, lëshon certifikatën për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, sipas formularit 7A, pjesë integrale e këtij udhëzimi. Kjo certifikatë është e vlefshme deri në përfundimin e projektit, sipas kritereve të parashikuara në dokumentin përkatës që rregullon këtë projekt.

Zbatuesi/përfituesi (nëse nuk ka zbatues) në momentin që blen mallra/shërbime të nevojshme për realizimin e projektit, paraqet te furnizuesi (shitësi) i tyre certifikatën e lëshuar nga DRT-ja, me qëllim që këto blerje të mos ngarkohen me TVSH.

Furnizuesi, në faturat që lëshon për zbatuesin/përfituesin (nëse nuk ka zbatues), duhet të pasqyrojë dispozitën e ligjit, konkretisht shkronja "c", pika 1, neni 60, sipas së cilës ky furnizim do të trajtohet si furnizim i përngjashëm me eksportet, me shkallë tatimore të TVSH-së zero për qind. Gjithashtu, në këto fatura duhet të pasqyrohet Kodi Unik i Identifikimit të Projektit, i përcaktuar në certifikatën e lëshuar nga Agjencia dhe numri i certifikatës përkatëse të lëshuar nga DRT-ja.

II. Kur zbatuesi/përfituesi (nëse nuk ka zbatues) e realizon projektin nëpërmjet kontraktorit, ky i fundit dorëzon pranë DRT-së ku është i regjistruar një kopje në gjuhën shqipe të noterizuar të kontratës së nënshkruar me zbatuesin/përfituesin, si dhe kopje të certifikatës së lëshuar nga Agjencia për zbatuesin/përfituesin (nëse nuk ka zbatues). DRT-ja regjistron në një regjistër të veçantë kontraktorin.

A. Nëse kontraktori nuk është subjekt i detyruar të regjistrohet për TVSH-në, sipas kërkesave të ligjit për TVSH-në, DRT-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune, lëshon certifikatën për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, sipas formularit 7A, pjesë integrale e këtij udhëzimi, ku evidentohet se kontraktori nuk është i detyruar të regjistrohet për TVSH-në. Kjo certifikatë është e vlefshme deri në përfundimin e kontratës. Në rast se gjatë periudhës së realizimit të kontratës, kontraktori plotëson kushtet për t'u

regjistruar për TVSH-në, atëherë ai detyrohet të njoftojë DRT-në, e cila e pajis kontraktorin me certifikatën ku është përditësuar përgjegjësia e tij tatimore si subjekt i regjistruar për TVSH-në.

Kjo certifikatë i mundëson kontraktorit të blejë mallra/shërbime në funksion të realizimit të kontratës së projektit pa TVSH. Kontraktori, në momentin që blen mallra/shërbime të nevojshme në funksion të realizimit të projektit, paraqet këtë certifikatë te furnizuesi (shitësi). Furnizuesi i mallrave/shërbimeve për kontraktorin, duhet të pasqyrojë në faturë Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të përcaktuar në certifikatën e lëshuar nga Agjencia dhe numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja.

Kontraktori, në faturat që lëshon për zbatuesin/përfituesin (nëse nuk ka zbatues), duhet të pasqyrojë dispozitën e ligjit, konkretisht shkronja "c", pika 1, neni 60, sipas së cilës ky furnizim do të trajtohet si furnizim i përngjashëm me eksportet, me shkallë tatimore të TVSH-së zero për qind, Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të përcaktuar në certifikatën e lëshuar nga Agjencia, si dhe numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja.

B. Nëse kontraktori është subjekt i detyruar të regjistrohet për TVSH-në, sipas kërkesave të ligjit për TVSH-në, DRT-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune, lëshon certifikatën për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, sipas formularit 7A, pjesë integrale e këtij udhëzimi, ku evidentohet se kontraktori është subjekt i detyruar të regjistrohet për TVSH-në. Kjo certifikatë është e vlefshme deri në përfundimin e kontratës.

Kontraktori, i pajisur me certifikatën si më sipër, blen mallra/shërbime për realizimin e projektit, të cilat mund të jenë të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja, sipas përcaktimeve të ligjit për TVSH-në. Për blerjet e kryera në funksion të realizimit të projektit, qofshin këto blerje me normë standarde apo të reduktuar të TVSH-së, kontraktori gëzon të drejtën e zbritjes së TVSH-së dhe të rimbursimit të saj, në përputhje me përcaktimet e neneve 68–84, të kreut IX, të ligjit.

Kontraktori, në faturat që lëshon për zbatuesin/përfituesin (nëse nuk ka zbatues), duhet të pasqyrojë dispozitën e ligjit, konkretisht shkronja "c", pika 1, neni 60, sipas së cilës ky furnizim do të trajtohet si furnizim i përngjashëm me eksportet, me shkallë tatimore të TVSH-së zero për qind, Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të përcaktuar në certifikatën e lëshuar nga Agjencia, si dhe numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja.

Kontraktori, furnizimin e mallrave/shërbimeve të realizuara në zbatim të shkronjës "c", pika 1, neni 60, të ligjit, e deklaron në librin e shitjeve dhe më pas në formularin e deklarimit të TVSH-së në rubrikën "Furnizime me shkallë 0%", ndërsa blerjet e realizuara për qëllim të kësaj skeme, në librin e blerjeve dhe më pas në rubrikën "Blerje të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH".

Furnizuesit e mallrave/shërbimeve për kontraktorin, qofshin këto furnizime të tatueshme me TVSH apo të përjashtuara nga TVSH-ja, do të pasqyrojnë në faturë Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të përcaktuar në certifikatën e lëshuar nga Agjencia, si dhe numrin e certifikatës së lëshuar nga DRT-ja.

Për të gjitha rastet e parashikuara më sipër, certifikata për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, sipas formularit 7A, i dërgohet zbatuesit/përfituesit (nëse nuk ka zbatues)/kontraktorit, nga ana e DRT-së përkatëse, nëpërmjet postës elektronike dhe shërbimit postar rekomande, në përputhje me përcaktimet e ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

4. Procedura për përjashtimin nga TVSH-ja në import

Në zbatim të pikës 45, të nenit 56, të ligjit, përjashtohen nga TVSH-ja në import, mallrat e destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime.

Për qëllime të zbatimit të përjashtimit në import, zbatuesi/përfituesi (nëse nuk ka zbatues)/kontraktori i projektit, të cilët mund të kryejnë importe mallrash në kuadër të kësaj skeme, do të pajisen me autorizim nga drejtori i përgjithshëm i Doganave. Për marrjen e këtij autorizimi, zbatuesi/përfituesi/kontraktori i projektit duhet të paraqesë me shkrim pranë DPD-së:

a) Kërkesën për përjashtim nga TVSH-ja në importin e mallrave të destinuara për projektin;

b) Kopje të Certifikatës së Regjistrimit të Projektit, përfshirë Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të lëshuar nga Agjencia;

c) Kopje të Certifikatës për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, të lëshuar nga DRT-ja ku importuesi është i regjistruar;

d) Kopje të noterizuar të kontratës/ave ndërmjet zbatuesit/përfituesit me kontraktorin/ët.

DPD-ja, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të kërkesës, shqyrton aplikimin për përjashtim dhe lëshon autorizimin nëse dokumentacioni është i saktë. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, DPD-ja njofton menjëherë subjektin aplikues për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-ditor (dhjetëditor). Me plotësimin e dokumentacionit, DPD-ja lëshon autorizimin për përjashtimin nga TVSH-ja në import. Ky

autorizim regjistrohet në sistemin informatik të DPD-së. Brenda datës 5 (pesë) të çdo muaji, DPD i përcjell DPT-së listën e detajuar të autorizimeve të dhëna.

5. Procedura online për pajisjen me certifikatë nga Agjencia dhe DRT-ja, si dhe me autorizim nga DPD-ja

Dispozitat e mësipërme zbatohen deri në momentin kur procedura për pajisjen me Certifikatën e Regjistrimit të Projektit, të lëshuar nga Agjencia, Certifikatën për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, të lëshuar nga DRT-ja përkatëse dhe autorizimin për përjashtimin nga TVSH-ja në import, të lëshuar nga DPD-ja, do të kryhet online nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania, sipas procedurës së paraqitur në këtë portal.

6. Monitorimi dhe kontrolli i furnizimeve për llogari të projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti, të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj.

Administratat tatimore dhe doganore, sipas fushës së përgjegjësisë, monitorojnë analizojnë dhe verifikojnë furnizimet dhe importet e kryera në kuadër të skemës së parashikuar në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 60, të ligjit nga:

a) Kontraktorët, të cilët aplikojnë TVSH zero për qind për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve për zbatuesit/përfituesit e projekteve;

b) Zbatuesit/përfituesit e projekteve dhe kontaktorët sipas pikës 3/II/A, të cilët furnizohen me mallra dhe shërbime me TVSH zero për qind.

Administrata tatimore ka detyrimin e kontrollit, verifikimit, kryqëzimit të të dhënave të deklaruara nga zbatuesit/përfituesit/kontraktorët e projekteve në librat e tyre të shitjeve dhe blerjeve, si dhe në deklaratën e TVSH-së, me qëllim garantimin e trajtimit me TVSH zero për qind vetëm për furnizimet e parashikuara në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 60, të ligjit.

Procedurat e detajuara të verifikimit të transaksioneve objekt i kësaj dispozite, kontrollit të tyre dhe rimbursimit të kontraktorëve për rastet kur plotësohen kriteret ligjore, detajohen nga DPT-ja në pjesën e Manualit të Kontrollit të dedikuar për këto transaksione dhe subjekte.

7. Agjencia, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, njofton të gjitha subjektet e pajisura më parë me certifikatë, për të aplikuar për pajisjen me Certifikatë për Regjistrimin e Projektit, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi. Agjencia i pajis këto subjekte me Certifikatën e Regjistrimit të Projektit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së aplikimit.

Certifikatat e Regjistrimit të Projektit, të lëshuara nga Agjencia përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, humbasin vlefshmërinë.

Certifikatat për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet, sipas formularit 7A, të lëshuara nga DRT-ja përkatëse përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, humbasin vlefshmërinë.

8. Përjashtimisht, për të gjitha mallrat/shërbimet e destinuara për realizimin e projekteve objekt i këtij neni, për të cilat është paguar TVSH-ja përpara pajisjes me Certifikatë për Regjistrimin e Projektit sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, si dhe në marrëveshjet e ratifikuara nga Kuvendi ose të miratuara nga Këshilli i Ministrave është parashikuar se, mospërdorimi i burimeve financiare të huaja për të paguar tatime (TVSH) bëhet efektiv edhe nëpërmjet mekanizmit të rimbursimit, TVSH-ja e paguar rimbursohet sipas procedurës së mëposhtme.

Rimbursimi që kryhet në këto raste nuk i nënshtrohet analizës së riskut dhe kontrolli tatimor për këtë qëllim nuk është i detyrueshëm përpara rimbursimit. Me përjashtim të rasteve kur TVSH-ja e paguar përballohet si kosto lokale nga përfituesi vendës i projektit, institucion buxhetor, çdo procedurë për rimbursimin e TVSH-së kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe përfundon brenda 30 (tridhjetë) ditëve, përfshirë edhe rimbursimin e shumave nga strukturat përgjegjëse të Thesarit.

Në këto raste, subjekti që ka paguar TVSH-në për mallrat/shërbimet në kuadër të zbatimit të projektit objekt i këtij neni, i drejtohet Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH-së në DPT me një kërkesë për rimbursim, së bashku me dokumentacionin shoqërues si më poshtë:

a) Dokumenti i lëshuar nga ana e Agjencisë që vërteton se projekti për të cilin kërkohet rimbursimi i TVSH-së, është financuar me fonde të marra mbi bazën e një marrëveshje donacioni/granti dhe plotëson kushtet sipas kësaj pike për rimbursimin e TVSH-së;

b) Kopje e Certifikatës së Regjistrimit të Projektit sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, përfshirë Kodin Unik të Identifikimit të Projektit, të lëshuar nga Agjencia;

c) Projektfisha, shoqëruar me buxhetin indikativ të aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë jetëgjatësisë së projektit;

d) Kopje të faturave të fiskalizuara për të cilat është paguar TVSH-ja, së bashku me listën e tyre, sipas formularit 6R/1, pjesë integrale e këtij udhëzimi;

e) Dokumenti i lëshuar nga donatori ose institucioni/entiteti i autorizuar/deleguar zyrtarisht prej tij, që vërteton/konfirmon se këto shpenzime janë kryer në kuadër të këtij projekti;

f) Dokumenti që vërteton se këto shpenzime nuk janë financuar si kosto lokale, në rastet kur ka një përfitues vendës të projektit, institucion buxhetor;

g) Raporti i verifikimit të shpenzimeve dhe nëse është i aplikueshëm edhe raporti i auditit, për të gjitha shpenzimet për të cilat kërkohet rimbursimi i TVSH-së.

Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në DPT, i kërkon subjektit plotësimin e dokumentacionit, nëse gjatë shqyrtimit të kërkesës vlerëson nevojën për dokumentacion shtesë.".

Neni 4

Neni 63/2 "Procedura e përjashtimit në import dhe trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet për marrëveshjet e grantit për programet/projektet e financuara nga asistenca financiare e Bashkimit Evropian", shfuqizohet.

Neni 5

Certifikata e Regjistrimit të Projektit e lëshuar nga Agjencia, formulari 7A "Certifikatë regjistrimi të projektit/kontratës për efekt të trajtimit si furnizim i përngjashëm me eksportet", Deklarata e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar, si dhe Librat e Shitjeve dhe Blerjeve, zëvendësohen përkatësisht sipas formateve bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

FORMULAR APLIKIMI

Për regjistrimin e projektit me donacion/grant nga burime të huaja

në Republikën e Shqipërisë

data : __ / __ / _____

_____

/emri i projektit në gjuhën Shqipe/

_____

/emri i projektit në gjuhën Angleze/

financuar nga:

_____

Me paraqitjen e këtij Formulari, ne, i drejtohemi Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, që të pranojë kërkesën tonë për regjistrimin e projektit të sipër përmendur me donacion/grant nga burime të huaja dhe të lëshojë Certifikatën e Regjistrimit të Projektit - në përputhje me nenin 63/1, paragrafi 2, shkronja b), të Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në zbatim të Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe _____**(donatori)**, datë __ / __ / ____, në të cilën përcaktohet në mënyrë të qartë që fondet e dhuruara nuk do të përdoren për pagesën e taksave, tarifave dhe detyrimeve me efekt të barazvlefshëm në Republikën e Shqipërisë.

1. **Të dhëna bazë të projektit*** (FUSHA TË DETYRUESHME PËR T'U PLOTËSUAR)

   1.1. ***a) Vlera indikative e projektit financuar me donacion/grant:_____, monedha:_____*
   b) Vlera indikative e projektit financuar me bashkëfinancim (në rast se është e aplikueshme):_____, monedha:_____

   1.2. *Data e fillimit të projektit:__/__/___ data e përfundimit të projektit:__/__/___*

   1.3. *Numri i identifikimit të projektit (nëse është i aplikueshëm):* _____

*Aplikanti deklaron se të gjitha të dhënat në këtë formular janë të vërteta dhe të sakta. Për çdo ndryshim në parametrat e projektit (p.sh. Kohëzgjatja, Shuma/Buxheti, etj.), aplikanti angazhohet të informojë në mënyrën dhe kohën e duhur Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.
**a) I referohet vlerës financiare të akorduar nga donatori/donatorët në formën e donacionit/grantit kundrejt entitetit/institucionit/organizatës zbatues/e të projektit, në kuadër të realizimit të një pjese apo të gjitha aktiviteteve të një projekti.
b) I referohet vlerës financiare të financuar nga burime buxhetore lokale/kombëtare në formën e bashkëfinancimit, në kuadër të realizimit të aktiviteteve të një projekti.

2. Baza ligjore

2.1. Marrëveshja kuadër: Ligji Nr._____, datë_____, "_____".

2.2. Marrëveshja e projektit ose kontrata e lidhur me donatorin apo çdo dokument të ngjashëm, me anë të së cilit rregullohet projekti konkret i financuar me fonde donacion/grant, shoqëruar me aktin miratues (nëse ka një të tillë).

2.3. Dokument referencë (vendim zbatues/miratues i Komisionit të BE-së ose dokument i ngjashëm zyrtar)[1]_____

3. Të dhëna identifikuese të donatorit[2] (FUSHA TË DETYRUESHME PËR T'U PLOTËSUAR)

DONATORI 1.	
emri i donatorit:	
adresa zyrtare:	
telefon: *fax.:*	*e-mail:*

4. Të dhëna identifikuese të zbatuesit/përfituesit (pa zbatues) (FUSHA TË DETYRUESHME PËR T'U PLOTËSUAR)

ZBATUESI/PËRFITUESI (PA ZBATUES)	
emri i entitetit/institucionit/organizatës:	
adresa zyrtare:	
NIPT/NUIS:	
telefon: *fax.:*	*e-mail:*
Emri i personit fizik të caktuar si personi përgjegjës për zbatimin e projektit (Udhëheqësi i Ekipit):	
funksioni:	*njësia/sektori:*
telefon:	*e-mail:*

5. Së bashku me këtë aplikim, përcjellim dokumentet mbështetëse[i] **si më poshtë:**

[1]Pika 2.3 është e aplikueshme vetëm për projektet nën IPA III, subjekt i Nenit 28 të Ligjit 65/2022, datë 15/09/2022 dhe që zbatohen nëpërmjet instrumenteve që nuk kanë një marrëveshje projekti apo kontratë (si p.sh. projektet e programeve IPA Rajonale, projektet Twinning, projektet TAIEX, asistencat teknike të WBIF, etj.).

[2]Në rastet kur ka dy ose më shumë donatorë të përfshirë, të kopjohet dhe ngjitet tabela në pikën 3 sa herë të jetë e nevojshme dhe të plotësohet informacioni për secilin prej donatorëve.

(**E RËNDËSISHME:** SHTOJCAT E MËPOSHTME JANË TË DETYRUESHME, PËR NDRYSHE APLIKIMI NUK DO TË KONSIDEROHET I VLEFSHËM[3]):

5.1. *Kopje e Kontratës së Donacionit/Grantit, të lidhur ndërmjet Zbatuesit të Projektit dhe Donatorit të huaj ose ndërmjet Përfituesit të Projektit (pa zbatues) dhe Donatorit të huaj (ose përfaqësuesit të tij të autorizuar), përfshirë një kopje të të gjitha Kontratave dytësore/të posaçme (nëse janë të aplikueshme);*[ii]

5.2. *Projekt fisha shoqëruar me buxhetin indikativ të aktiviteteve të planifikuara për t'u zbatuar gjatë jetëgjatësisë së projektit.*

emri i plotë i personit përgjegjës në entitetin aplikues

funksioni i personit përgjegjës

Vula e entitetit aplikues *nënshkrimi i personit përgjegjës*

[i]Dokumentat e përcaktuara në këtë pikë, paraqiten në gjuhën/gjuhët që janë nënshkruar nga palët. Për dokumentat që nuk janë në gjuhën angleze, përveçse në gjuhën origjinale, ato duhet të paraqiten edhe të përkthyera zyrtarisht në gjuhën shqipe.

[ii]Në rast se dokumenti përmban dispozita me karakter konfidencial, ato mund të mos jenë pjesë e këtij dokumentacioni.

[3]Me përjashtim të projekteve nën IPA III, subjekt i Nenit 28 të Ligjit 65/2022, datë 15/09/2022 dhe që zbatohen nëpërmjet instrumenteve që nuk kanë një marrëveshje projekti apo kontratë (si p.sh. projektet e programeve IPA Rajonale, projektet Twinning, projektet TAIEX, asistencat teknike të WBIF, etj.).

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

CERTIFIKATË REGJISTRIMI TË PROJEKTIT/KONTRATËS PËR EFEKT TË TRAJTIMIT SI FURNIZIM I PËRNGJASHËM ME EKSPORTET

Formular 7A

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE _____

Numri i Certifikatës në regjistrin e DRT-së: _____

Kodi Unik i Identifikimit të Projektit: _____

1. Emri i zbatuesit/përfituesit të projektit:		2. NIPT:	
3. Data e fillimit të projektit/kontratës:		4. Data e mbarimit të projektit/kontratës:	
5. Titulli i projektit/kontratës:		6. Donatori i grantit:	

7. Të dhëna mbi kontraktorin (kur është e aplikueshme)

Statusi në kontratë	**Emri**	**NIPT**	**Subjekt i TVSH-së**		**Kontrata: Numri/data/ afati:**	**Vlera e Kontratës:**
			PO	JO		
Kontraktor	xxx	yyy				

8. Marrëveshja ndërkombëtare e ratifikuar që parashikon mospërdorimin e fondeve për të paguar tatime (referenca e nenit dhe ligjit ratifikues)	

DREJTORI **Nënshkrimi: _____**	**Data: _____**

Kjo certifikatë lëshohet në zbatim të nenit 60, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 92/2014 "Për TVSH-në në R.SH", i ndryshuar dhe nenit 63/1 të udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015, "Për TVSH-në në R.SH", i ndryshuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Formular 6R/1

KËRKESË PËR RIMBURSIM TË TVSH-së
(Për subjektet që kanë kontratë donacioni/granti me donator)

Emri i subjektit mbajtës i Certifikatës së Regjistrimit të Projektit të lëshuar nga Agjencia:	
NIPT-i:	
Kodi Unik i Identifikimit të Projektit të lëshuar nga Agjencia:	
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit ligjor:	
Kontakt (Tel./e-mail):	

Kërkoj rimbursimin e TVSH-së së paguar në blerje për:

Emri i Subjektit	NIPT	Emër, mbiemër dhe kontakt i përfaqësuesit ligjor	Zbatues/Përfitues (nëse nuk ka zbatues)/Kontraktor	(TVSH) Shuma e kërkuar në lekë	Llogaria bankare
			TOTALI		

(Nënshkrimi i Subjektit) (data)

Formular 6R/1

Lista e blerjeve me TVSH të bëra nga subjektet në kuadër të implementimit të kontratës së donacionit/grantit*

Nr. ref. në tab. e shpenz.**	Numri serial i faturës së shitjes	Data e faturës	Emri i shitësit	NIPT-i i shitësit	Emri i blerësit	NIPT-i i blerësit	Zbatues/Përfitues (nëse nuk ka zbatues)/Kontraktor	Përshkrimi i mallit apo shërbimit të blerë	Vlera pa TVSH (në lekë)	TVSH (në lekë)
								TOTALI		

(Nënshkrimi i Subjektit) (data)

*** Kjo listë dorëzohet pranë organit tatimor edhe në format elektronik në *Excel*.**

**** Vendos nr. rendor që fatura/shpenzimi ka në tabelën e shpenzimeve që subjekti i ka dorëzuar kontrolluesit të shpenzimeve/autoritetit kontraktues/donatorit.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DEKLARATA E TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR

Numri i Vendosjes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT): (3)_____
Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm: (4)_____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: (5)_____
Adresa: (6)_____
Qyteti/Komuna/Rrethi: _____
Numri Telefonit: (7)_____

Informacioni i mësipërm (rubrikat 4,5,6,7) duhet të jetë i saktë dhe i azhornuar

[8] Shënoni 'X' nqs gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion. ☐

TVSH e llogaritur për muajin	Vlera e tatueshme	TVSH e llogaritur
(9) Shitje të përjashtuara	(9)	
(10) Shitje pa TVSH	(10)	
(11) Eksporte mallrash	(11)	
(12) Furnizime me shkallë 0%	(12)	
(13) Shitje të tatueshme (me shkallë 20%)	(13)	(14)
(15) Shitje të tatueshme (me shkallë 10%)	(15)	(16)
(17) Shitje të tatueshme (me shkallë 6%)	(17)	(18)
(19) Shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të udhetimit/ të marzhit të fitimit/të shitjeve në ankand (20%)	(19)	(20)
(21) Autongarkesë TVSH-së në shitje (reverse charge) (21 x 20%)	(21)	(22)
(23) Borxhi i keq	(23)	(24)
(25) Totali TVSH-së së llogaritur {(14)+(16)+(18)+(20)+(22)+ (24)}		(25)

TVSH e zbritshme për muajin	Vlera e tatueshme	TVSH e zbritshme
(26) Blerje të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH	(26)	
(27) Blerje investimi brenda vendit pa TVSH	(27)	
(28) Importe të perjashtuara te investimit pa TVSH	(28)	
(29) Import mallra të përjashtuara nga TVSH	(29)	
(30) Import mallra me shkallë tatimore 20%	(30)	(31)
(32) Import mallra me shkallë tatimore 10%	(32)	(33)
(34) Import mallra me shkallë tatimore 6%	(34)	(35)
(36) Importe te investimit me TVSH 20%	(36)	(37)
(38) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 20%	(38)	(39)
(40) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 10%	(40)	(41)
(42) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 6%	(42)	(43)
(44) Blerje te Investimit Brenda vendit me TVSH 20%	(44)	(45)
(46) Blerje nga fermerët vendas (0%)	(46)	(47)
(48) Autongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (reverse charge)	(48)	(49)
(50) Rregullime të TVSH-së së zbritshme	(50)	(51)
(52) Borxhi i keq	(52)	(53)
(54) Totali TVSH-së së zbritshme {(31)+(33)+(35)+(37)+(39)+(41)+(43)+(45)+(47)+(49))+(51)+(53)}		(54)

(55) Teprica e TVSH së zbritshme për muajin {(25)-(54) }nqs{(25)<(54)}		(55)
(56) TVSH I DETYRUESHËM PËR TU PAGUAR {(25)-(54) }nqs{(25)>(54)}		(56)

Data dhe Firma e Personit të Tatueshëm - Deklaroj nën përgjegjësine time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

Deklaratë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (DTVSH)

1. Numri serial perdoret nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe shërben për të azhornuar regjistrimet tuaja kur paraqitet deklarata.
2. Periudha Tatimore është muaji i paraqitur nga dita e parë deri në ditën e fundit.Të gjitha transaksionet (Shitjet, Blerjet) dhe llogaritjet mujore të TVSH-së të kryera gjatë kësaj periudhe duhet te perfshihen ne kete deklarate.

Të dhëna të Personit të Tatueshëm

3. Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT/NUIS) është numri i vetëm që ju përfaqësoni dhe identifikon në të gjitha marrëdhëniet me Administratën Tatimore Qëndrore. Nipt/ Nuis duhet të vendoset detyrimisht në çdo faturë që lëshoni ose merrni.
4. Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm është emri tregtar me të cilin ju jeni regjistruar në QKR ose Drejtorinë Rajonale Tatimore sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe që tregohet në certifikatën tuaj të regjistrimit si NIPT/NUIS.
5. Emri, Mbiemri i Personit Fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një Person Fizik dhe nuk ka emër tregtar.
6. Adresa tregohet për vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tuaj ekonomike. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën tuaj të NIPT/NUIS.
7. Numri i Telefonit (nqs keni) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tuaj ekonomike.
Shënim. Nëqoftëse ndonjë nga të dhënat e rubrikave 4,5,6,7 ka ndryshuar, jeni të detyruar të deklaroni në kohë, çdo ndryshim pranë QKR-së ose Drejtorisë Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.
8. Nëqoftëse ju nuk keni kryer asnjë transaksion gjatë muajit, shënoni një "X" në kutinë 8. Sipas mënyrës së deklarimit, plotësoni datën dhe firmosni duke deklaruar në këtë mënyrë që informacioni i dhënë në deklaratë është i plotë dhe i saktë.

TVSH e llogaritur për muajin

9. Nga kolona **"ë" -"Shitje të përjashtuara"** e librit tuaj të shitjeve nxirrni totalin e të gjithë shitjeve të përjashtuara të muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 9 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitjet e përjashtuara sipas Kapitullit 8 seksioni 1 të ligjit, për të cilat nuk llogaritet TVSH.
10. Nga kolona **"f"- "Shitje pa TVSH"** e librit tuaj të shitjeve nxirrni totalin e të gjithë shitjeve pa TVSH të muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 10 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitje të patatueshme në Shqipëri për të cilat nuk llogaritet TVSH.
11. Nga kolona **"g"- "Eksporte mallrash" të** librit tuaj të shitjeve nxirrni totalin e të gjithë eksporteve të mallrave me shkallë tatimore 0% të bëra për muajin dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 11 të Deklaratës tuaj. Furnizimet Eksporte sipas nenit 57 të ligjit tatohen me shkallë 0%
12. Nga kolona **"gj"- "Furnizime me shkallë 0%"** e librit tuaj të shitjeve nxirrni totalin e të gjithë furnizimeve me shkallë tatimore 0% të bëra për muajin dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 10 të Deklaratës tuaj, furnizime sipas Kapitullit 8 Seksioni 3 përveç eksportit të mallrave që deklarohet ne kutine 11 si dhe furnizimet e mallrave/shërbimeve të realizuara në zbatim të shkronjës "c", pika 1, neni 60, të ligjit, të cilat deklarohen në librin e shitjeve dhe më pas në formularin e deklarimit të TVSH-së në rubrikën 12 "Furnizime me shkallë 0%"
13. Nga kolona **"h"- "Vlera e Tatueshme për shitje me shkallë 20%"** nxirrni totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit të cilat sipas ligjit që i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 20%. dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 13 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-)
14. Nga kolona **"i"** e Librit të shitjeve **"TVSH për shitje me shkallë 20%"**, nxirrni totalin e tvsh-së për muajin për shitjet me shkallë 20% dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 14 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 14 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 13.(vlera+/-)
15. Nga kolona "**j**" e Librit të shitjeve "Vlera e Tatueshme për shitje me shkallë 10%" nxirrni totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit, të cilat sipas ligjit, i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 10% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 15 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-)
16. Nga kolona "**k**" e Librit të shitjeve "TVSH për shitje me shkallë 10%, nxirrni totalin e TVSH- së për muajin për shitjet me shkallë 10% dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 16 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 16 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 15. (vlera +/-).
17. Nga kolona "**l**" e Librit të shitjeve "Vlera e Tatueshme për shitje me shkallë 6%" nxirrni totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit, të cilat sipas ligjit, i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 6% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 17 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-)
18. Nga kolona **"ll"** e Librit të shitjeve "TVSH për shitje me shkallë 6%, nxirrni totalin e TVSH- së për muajin për shitjet me shkallë 6% dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 18 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 18 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 17. (vlera +/-)
19. Nga kolona **"m"** e Librit të shitjeve **"Vlera e Tatueshme për Shitje sipas regjimit te agjentëve të udhëtimit/ marzhi fitimit /shitje në ankand"** nxirrni totalin për transaksionet e bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 19 të Deklaratës tuaj. Këto shitje të tatueshme i nënshtrohen shkallës 20% të TVSH-së.
20. Nga kolona **"n"** e Librit të shitjeve **"TVSH për Shitje regjimi agjentëve të udhëtimit/ marzhi fitimit /shitje në ankand"**, nxirrni totalin e TVSH-së të shitjeve për muajin dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 20 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 20 duhet të jetë e barabartë me 20 % të vlerës së paraqitur në kutinë 19.
21. Nga kolona **"nj"** e Librit të shitjeve **"Vlera e Tatueshme për Autongarkesë TVSH në shitje"** nxirrni totalin per transaksionet për të cilat llogariten autongarkesë TVSH në shitje të bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 21 të Deklaratës tuaj. Këto transaksione deklarohen sipas shkallës tatimore standarte dhe/ose të reduktuar të TVSH-së në shitje sipas legjislacionit tatimor në fuqi.
22. Nga kolona **"o"** e Librit të shitjeve **"TVSH e autongarkuar në shitje "**, nxirrni totalin e TVSH-së për transaksionet për të cilat llogaritet autongarkesë TVSH në shitje per muajin dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 22 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 22 duhet të jetë e barabarte me vlerën e kutisë 21 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/ose te reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi.
23. Nga kolona **"p"** e Librit të shitjeve **"Vlera e Tatueshme për veprime te Borxhit e keq"** nxirrni totalin për muajin të transaksioneve sipas nenit 84 të Ligjit, dhe vendoseni në kutinë 23 të Deklaratës tuaj. Shkalla e zbatueshme e TVSH-së është sipas legjislacionit tatimor në fuqi (vlera +/-)
24. Nga kolona **"q"** e Librit të shitjeve "**TVSH për veprime të Borxhit e keq"**, nxirrni totalin e TVSH-së për arkëtimet e Borxhit të keq për muajin dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 24 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 24 duhet të jetë e barabartë me vlerën e kutisë 23 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi.
25. Llogarisni **totalin e TVSH së mbledhshmepër muajin**, duke mbledhur TVSH e llogaritur për Shitje të tatueshme me 20% (kutia14), Shitje të tatueshme me 10% (kutia 16), Shitje të tatueshme me 6% (kutia 18), TVSH e llogaritur për shitje të tatueshme sipas regjimeve te agjentit udhetimi/marzhit fitimit/ shitje në ankand, me 20 % (kutia 20); TVSH e llogaritur për transaksionet e blerjes se shërbimeve nga persona jo rezident e autongarkuar në shitje me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar (kutia 22), TVSH e mbledhshme nga veprime te Borxhit të keq me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar (kutia 24). Shumën plotësojeni në kutinë 25. (vlera +/)

TVSH e zbritshme gjatë Muajit

26. Nga kolona **"ë"** e Librit tuaj të Blerjeve **"Blerje të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh"**, nxirrni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 26 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistrohen blerjet e përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, si dhe blerjet e realizuara për qëllim të pika 1, neni 60, të ligjit përveç blerjeve të tilla të kryera për investime të cilat regjistrohen vetëm as në kutinë 27. Për blerjet me TVSH jo të zbritshme nuk do të bëhet zbritje e TVSH
27. Nga kolona **"f"**e Librit tuaj të Blerjeve-**"Blerje investime brenda vendit pa TVSH"**. Këtu regjistrohen vetëm blerjet e kryera për qëllime investimi në pasuriné e subjektit të kryera brenda vendit dhe pa Tvsh si p.sh. blerjet e përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, për investime. Nxirrni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 27 të Deklaratëstuaj.
28. Nga kolona **"g"**e Librit tuaj të Blerjeve-**"Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH"**, nxirrni totalin e importeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 28 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e kryera për qëllime investimi në pasuriné e subjektit.
29. Nga kolona **"gj"**e Librit tuaj të Blerjeve-**"Import mallra të përjashtuara"**, nxirrni totalin e importeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 29 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistro- hen të gjitha importet e mallrave të përjashtuara nga TVSH, përveç importeve të perjashtuara për investime të cilat regjistrohen vecmas në kutinë 28.
30. Nga kolona **"h"-"Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 20%"** e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirrni totalin e vlerës së tatueshme të importev e të mallrave me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përftuar, në kutinë 30 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë36.
31. Nga kolona **"i"- "TVSH në Import për mallra me shkallë 20%"** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirrni totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 31 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 31 duhet të jetë e barabartë me 20% te vlerës së kutisë 30.
32. Nga kolona **"j"-"Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 10%"** e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirrni totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 10% dhe plotësoni shumën e përftuar, në kutinë 32 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 10%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 36.
33. Nga kolona **"k"- "TVSH në Import për mallra me shkallë 10%"** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirrni totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 33 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 33 duhet të jetë e barabartë me 10% te vlerës së kutisë 32.
34. Nga kolona **"l"."Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 6%"** e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirrni totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 6% dhe plotësoni shumën e përftuar, në kutinë 34 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 6%, përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 36.
35. Nga kolona **"ll"- "TVSH në Import për mallra me shkallë 6%"** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirrni totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 35 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 35 duhet të jetë e barabartë me 6% te vlerës së kutisë 34.
36. Nga kolona **"m"-"Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%"** e Librit tuaj të Blerjeve, për muajin, nxirrni totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përftuar, ne kutinë 36 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20% te kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, te cilat deklarohen në kutinë 36.
37. Nga kolona **"n"- "TVSH në Import për investimi me shkallë 20%"** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirrni totalin e TVSH-së në import për mallrat të investimit dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 37 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 37 duhet të jetë e barabartë me 20% te vlerës së kutisë 36.
38. Nga kolona **"nj"-Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirrni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 38 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutine 44.(vlera +/-)
39. Nga kolona **"o"- "TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 39 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 39 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 38.(vlera+/-)
40. Nga kolona **"p"-Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirrni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 40 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutine 44.(vlera +/-)
41. Nga kolona **"q"- "TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 41 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 41 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së kutisë 40.(vlera+/-)
42. Nga kolona **"r"-Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirrni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 42 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç atyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutine 44.(vlera +/-)
43. Nga kolona **"rr"- "TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 43 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 43 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së kutisë 42.(vlera+/-)
44. Nga kolona **"s"-Vlera e tatueshme per blerje te investimit nga furnitore vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të Blerjeve, nxirrni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 44 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm blerjet brenda vendit te kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit.(vlera +/-)
45. Nga kolona **"sh"- "TVSH për blerje të investimit nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 45 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 45 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së kutisë 44.(vlera +/-)
46. Nga kolona **"t"-"Vlera e tatueshme e blerjeve nga fermerët vendas"** e Librit tuaj të Blerjeve nxirrni totalin e këtyre blerjeve nga fermerët e identifikuar me NIPT por jo te regjistruar per TVSH-ne dhe plotesoni shumën e përftuar në kutinë 46 të Deklaratës tuaj. Shkalla e zbatuar nga blerësi për këto blerje është 0%.
47. Nga kolona **"th"-TVSH i zbritshëm, kompensimi i fermerëve"** e Librit tuaj të Blerjeve, mbledhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 47 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 47 duhet të jetë e barabartë me 0% të vlerës së kutisë 46.
48. Nga kolona **"u"** e Librit te blerjeve **"Vlera e Tatueshme për Autongarkesë TVSH në blerje"** nxirrni totalin për transaksionet e blerjes së shërbimeve nga persona jo rezident ne Shqipëri për të cilat llogariten autongarkese TVSH në shitje, te bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përftuar ne kutinë 4 8 të Deklaratës tuaj. Shkalla e TVSH-së e zbatuar është sipas legjislacionit tatimor në fuqi.
49. Nga kolona **"v"** e Librit të blerjeve **"TVSH e autongarkuar në blerje "**, nxirrni totalin e tvsh-së për muajin të transaksioneve për të cilat llogaritet autongarkesë TVSH në blerje dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 49 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 49 duhet të jetë e barabartë me vlerën e kutisë 48 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi.
50. Nga kolona **"x"** e Librit të blerjeve **"Vlera e Tatueshme për Rregullim të TVSH së zbritshme"** nxirrni totalin për rregullimet e TVSH-së të kryera gjatë muajit, sipas neneve 78-83 dhe 73 pika 3 të Ligjit, dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 50 të Deklaratës tuaj. Shkalla e TVSH-se e zbatuar eshte sipas legjislacionit tatimorné fuqi.
51. Nga kolona **"xh"** e Librit të blerjeve **"TVSH e Rregulluar"**, nxirrni totalin e tvsh-së për rregullime të TVSH per muajin dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 51 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 51 duhet të jetë e barabarte me vlerën e kutisë 50 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi.(vlera +/-)
52. Nga kolona **"y"** e Librit te blerjeve **"Vlera e Tatueshme të Borxhit e keq"** nxirrni totalin e vlerave te tatueshmeve te borxhit të keq dhe regjistrojeni në kutinë 52 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen transaksione te borxhit të keq me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar të TVSH-së sipas legjislacionit tatimor në fuqi. (vlera +/-)
53. Nga kolona **"z"** e Librit te blerjeve **"TVSH për veprime të Borxhit e keq"**, nxirrni totalin e tvsh-së për faturimet e Borxhit të keq për muajin dhe shumën e përftuar vendoseni në kutinë 53 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 53 duhet të jetë e barabarte me vlerën e kutisë 52 shumëzuar me % përkatëse standarte dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi (vlera +/-)
54. Llogarisni **totalin e TVSH së zbritshëm për muajin**, duke mbledhur TVSH e zbritshme për Importet mallra me shkallë 20% (kutia 31), TVSH e zbritshme për Importet mallra me shkalle 10% (kutia 33); TVSH e zbritshme për Importet mallra me shkalle 6% (kutia 35), TVSH e zbritshme për Importet te investimeve me shkalle 20% (kutia 37);TVSH e zbritshme për Blerjet nga furnizuesit vendas me shkalle 20% (kutia 39), TVSH e zbritshme për Blerjet nga furnizuesit vendas me shkalle 10% (kutia 41), TVSH e zbritshëm për Blerjet nga furnizuesit vendas me shkalle 6% (kutia 43), TVSH e zbritshëm për Blerjet per investime nga furnizuesit vendas me shkalle 20% (kutia 45), TVSH (kompensimi) i paguar për blerjet nga fermerët (kutia 47);TVSH e llogaritur për transaksionet e blerjes se shërbimeve nga persona jo rezident e autongarkuar në blerje me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar (kutia 49), TVSH e rregulluar me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar sipas kutisë (51) TVSH e zbritshme nga veprime të Borxhit të keq me shkallë standarte dhe/ose të reduktuar (kutia 53). Shumën plotësojeni në kutinë 54. (vlera+/-)

Rezultati i TVSH për muajin

55. Në kutinë 55 të Deklaratës llogaritet Tepricë e TVSH-së zbritshme për muajin, zbritur vlerën e kutisë 54 nga vlera e kutisë 25, nqs totali i TVSH të zbritshëm për muajin (kutia 54) është më i madh se TVSH i llogaritur për shitjet e muajit te paraqitura ne kutinë 25. Pra keni si rezultat Tepricë të TVSH së zbritshme per muajin dhe nuk duhet të bëni pagesë TVSH në këtë muaj.
56. Në kutinë 56 të Deklaratës llogaritet TVSH e detyrueshëm për tu paguar duke zbritur vlerën e kutisë 54 nga vlera e kutisë 25, nqs shuma e TVSH-së së llogaritur për muajin me shkallë tatimore standarte dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tatimor në fuqi, në kutinë 25 të deklaratës është më i madh se totali i TVSH të zbritshme për muajin (kutia 54), pra keni rezultuar me TVSH të detyrueshme për tu paguar.

Shënime : Mbi plotësimin e Deklaratës së TVSH- së

Kjo deklaratë është konceptuar në bazë të Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 "Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe është e përshtatshme për të kryer deklarimin e TVSH-së sipas mënyrave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore .Deklarata duhet të plotësohet dhe deklarohet në mënyrë elektronike brenda datës 14 të muajit pasardhës të muajit të treguar në deklaratë. Pagesa e TVSH-së bëhet me Urdhër pagesë në bankë ose në mënyrë elektronike (nëse është e mundur pagesa elektronike) brenda datës 14 të muajit pasardhës të muajit të treguar në Deklaratë si periudhë tatimore. Urdhërpagesa do t'ju gjenerohet automatikisht nga sistemi pasi të keni plotësuar dhe dërguar këtë deklaratë. Nqs ju keni pagesë për të bërë dhe e bëni këtë pagesë të plotë brenda afatit mk ju aplikohen kamatevonesa ose gjoba për mospagesë në afat të vlerës së pagesës. Nqs bëhet një pagesë e pjesshme ose një pagesë e vonuar, detyrimi tuaj sipas kutisë 56 të kësaj deklarate i shtohen gjobat dhe interesat përkatëse nga data që do bytimi dubej paguar deri në datën kur kryhet pagesa.Vendosni datën e plotësimit të Deklarates, dhe dëgjoni deklaratën në mënyrë elektronike, kunjë kopje e kësaj deklarate do t'ju rihet
në llogarinë tuaj si tatimpagues. Për më shumë informacion lexoni aktet ligjore dhe nenligjore per TVSH-se, (Ligjin dhe Udhëzimin e TVSH- se etj) ose merrni kontakt me Drejtorine Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.

Libri i Shitjeve

Shoqëria	Emri i shoqërisë
NIPT-i	NIPT-i i shoqërisë
Viti	Viti për të cilin plotësohet libri (yyyy)
Muaji	Muaji për të cilin plotësohet libri – muaji nga 1 deri 12

Pa veprimtari ☐ Plotëso **PO** nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

Fatura			Blerësi			Totali i shitjeve	Shitjet e përjashtuara	Shitjet pa TVSH	Eksporte mallrash	Furnizime me 0%	Shitje me shkallë 20%		Shitje me shkallë 10%		Shitje me shkallë 6%		Shitje regjimi agjentëve të udhëtimit/marzhi i fitimit/ shitje në ankand		Autongarkesë TVSH në shitje		Borxh i keq	
Nr. faturës	Numri serial	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar/ personi	Rrethi	NIPT						Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH
a	b	c	ç	d	dh	e=(ë+f+g+gj+h+i+j +k+l+ll+m+n+nj+o+p+q)	ë	f	g	gj	h	i= (h) x 20%	j	k = (j)x 10%	l	ll = (l)x 6%	m	n = (m) x 20%)	nj	o = (nj) x 20/10/6 %)	p	q = (p) x 20/10/6 %)
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
Shuma totale						0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kutia sipas Formularit të Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së							kutia (9)	kutia (10)	kutia (11)	kutia (12)	kutia (13)	kutia (14)	kutia (15)	kutia (16)	kutia (17)	kutia (18)	kutia (19)	kutia (20)	kutia (21)	kutia (22)	kutia (23)	kutia (24)

Emri Mbiemri

Shpjegim:
Në rastin kur ky libër do të printohet, për qëllime të ruajtjes/mbajtjes së dokumentacionit, çdo faqe e printuar duhet të ketë në krye përmbajtjen/rreshtat nga 1 në 12.
Nr. i rreshtave mund të shtohet në përputhje me nr. e transaksioneve.

Libri i Blerjeve

Shoqëria Emri i shoqërisë
NIPT-i NIPT-i i Shoqërisë
Viti
Muaji

Pa veprimtari ☐ Plotëso **PO** nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

Fatura			Shitësi			Totali (përfshirë TVSH)	Blerje																								Të tjera veprime					
Nr. i faturës	Numri serial	Data (dd.mm.yyyy)	Emri tregtar/personi	Rreshti	NIPT/Kodi i fermerit		Të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme/pa TVSH	Blerje investime brenda vendit pa TVSH	Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH	Import mallra të përjashtuara	Importe mallra me shkallë 20%		Importe mallra me shkallë 10%		Importe mallra me shkallë 6%		Importe të investimit me shkallë 20%		Nga furnitorë vendës me shkallë 20%		Nga furnitorë vendës me shkallë 10%		Nga furnitorë vendës me shkallë 6%		Të investimit nga furnitorë vendës me shkallë 20%		Nga fermerët vendës		Autongarkesë TVSH në blerje me të drejtë kreditimi		Rregullime të TVSH-së së zbritshme		Veprime të borxhit të keq	
											Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH	Vlera e Tatueshme	TVSH
a	b	c	ç	d	dh	c=(ë+f+g+gj+h+i+j+k+l+ll+m+n+nj+o+p+q+r+rr+s+sh+t+th+u+v+x+xh+y+z)	ë	f	g	gj	h	i = (h) x 20%	j	k = (j) x 10%	l	ll = (l) x 6%	m	n = (m) x 20%)	nj	o = (nj) x 20%)	p	q= (p) x 10%)	r	rr= (r) x 6%)	s	sh = (s) x 20%)	t	th= (t) x 0 %)	u	v = (u) x 20/10/6 %)	x	xh = (x) x 20/10 /6 %)	y	z = (y) x 20/10/ 6 %)
						0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
						0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
						0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
					0	0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
					0	0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
					0	0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
					0	0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
					0	0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
					0	0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
					0	0						0		0		0		0		0		0		0		0		0									
Shuma totale						0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kutia sipas Formularit të Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së							kutia (26)	kutia (27)	kutia (28)	kutia (29)	kutia (30)	kutia (31)	kutia (32)	kutia (33)	kutia (34)	kutia (35)	kutia (36)	kutia (37)	kutia (38)	kutia (39)	kutia (40)	kutia (41)	kutia (42)	kutia (43)	kutia (44)	kutia (45)	kutia (46)	kutia (47)	kutia (48)	kutia (49)	kutia (50)	kutia (51)	kutia (52)	kutia (53)		

Emri Mbiemri

Shpjegim:
Në rastin kur ky libër do të printohet, për qëllime të ruajtjes/mbajtjes së dokumentacionit, çdo faqe e printuar duhet të ketë në krye përmbajtjen/rreshtat nga 1 në 12.
Nr. i rreshtave mund të shtohet në përputhje me nr. e transaksioneve.

Agjencia Shtetërore e
Programimit Strategjik dhe
Koordinimit të Ndihmës

CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT TË PROJEKTIT

EMËRTIMI I PROJEKTIT

TË DHËNA PËR ZBATUESIN / PËRFITUESIN E PROJEKTIT

NIPT / NUIS

DATA E FILLIMIT TË PROJEKTIT

D D M M V V V V

DATA E PËRFUNDIMIT TË PROJEKTIT

D D M M V V V V

KODI UNIK

DATA E LËSHIMIT

D D M M V V V V

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

UDHËZIM
Nr. 7, datë 21.2.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 21, DATË 18.7.2024, "PËR RREGULLAT PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR ÇRRËNJOSJEN DHE PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË *GLOBODERA PALLIDA* (GURIT) BEHRENS DHE *GLOBODERA ROSTOCHIENSIS* (WOLLENWEBER) BEHRENS[1]"

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 21, datë 18.7.2024, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 13 shfuqizohet.

2. Në aneksin III, shkronja "b", të pikës 1, bëhen ndryshime si më poshtë:

a) shkronja "ii" ndryshohet me formulimin si vijon:

"ii) izolimi i cisteve *Globodera* nga mbetjet bazuar në morfologjinë e cistit, i ndjekur nga identifikimi i specieve bazuar në morfologjinë e cisteve individuale dhe të vegjlit (*juvenilies*), i kombinuar me *real-time PCR*, bazuar në *Gamel et al*., 2017 ose *real-time PCR*, bazuar në *Lombard et al.* 2024(*1)";

b) pas shkronjës "iii" shtohet pika "iv" me këtë përmbajtje:

"iv) izolimi i cisteve nematode nga mbetjet bazuar në morfologjinë e cisteve, i ndjekur nga zbulimi dhe identifikimi i specieve, bazuar në *real-time PCR*, të cisteve të qëndrueshme (*viable*) dhe të vegjlit (*juvenilies*) të gjallë bazuar në *Lombard et al.* 2024".

(*1) Lombard L, Dekker-Nooren CCEM, Wuijster B, van Kessel, SP, van Duivenbode I, van Bruggen AS, van Heese EYJ (2024), Krahasimi i efektivitetit të real-time PCR-ve për të treguar dhe për të treguar sigurinë. *Globodera pallida* dhe *G. rostochiensis*. Eur J Plant Pathol, https: // doi.org / 10.1007 / s10658-024-02864-7.

3. Aneksi IV zëvendësohet me aneksin bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

[1] Ky udhëzim përafron plotësisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2024/2060, e datës 30 korrik 2024 për ndryshimin e rregullores zbatuese të Komisionit (BE) 2022/1192, në lidhje me modelin për vrojtimet e *Globodera pallida* (Gurit) Behrens dhe *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens, përdorimin e metodave të testimit dhe përcaktimin e vendndodhjeve të prodhimit të infektuar.

ANEKSI IV

Modeli i vrojtimit referuar në nenet 3 dhe 6

Modeli për paraqitjen e rezultateve të vrojtimit të nematodes së cisteve të patates të kryera gjatë vitit kalendarik që i paraprin vitit të raportimit.
Tabela e mëposhtme përdoret vetëm për patatet e korrura në vendin tonë.

Rajonet ose zonat	Lloji i vrojtimit	Kategoria	Zona e kultivimit (ha) (1)	Zona e vrojtimit (ha)	Norma e aplikuar e mostrimit sipas pikave 1-7 të aneksit III të udhëzimit nr. 21, datë 18.7.2024 (2)	Zona e infektuar pas testeve laboratorike (ha)			Madhësia fillestare e zonës së infektuar (5) (ha)	Madhësia e përditësuar e zonës së infektuar (6) (ha)	Numrat e njoftimit të shpërthimeve të reja të njoftuara, sipas rastit, në përputhje me nenin 15, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar	Informacione të tjera
						Vetëm *G. p.* (3)	Vetëm *G. r.* (4)	*G. f.* dhe *G.r.* të pranishme së bashku në të njëjtin vendndodhje prodhimi				
	Zbulimi (nenit 3 të udhëzimit nr. 21, datë 18.7.2024)	- Zhardhokët e patates për prodhimin e zhardhokëve për mbjellje (7) dhe; - Bimë të tjera bujtëse, siç renditen në aneksin I të udhëzimit nr. 21, datë 18.7.2024										
	Monitorimi (neni 6 i udhëzimit nr. 21, datë 18.7.2024	Patate të tjera nga ato për mbjellje										

(1) E rëndësishme vetëm në rastin e vrojtimeve monitoruese.
(2) Shkalla e mostrimit në kuptimin e aneksit III të udhëzimit nr. 21, datë 18.7.2024 (kryesisht e përcaktuar nga madhësia e mostrës); përdorni një rresht individual për çdo normë mostrimi, përkatësisht.
(3) *Globodera pallida*.
(4) *Globodera rostochiensis*.
(5) Sipërfaqja totale e zonës së infektuar në vitin, para vitit të mbuluar nga raporti.
(6) Sipërfaqja totale e zonës së infektuar në vitin e mbuluar nga raporti.
(7) Asnjë vrojtim zbulimi nuk kërkohet për mbjelljen e patateve të destinuara për prodhimin e zhardhokëve të patates që do të përdoren brenda të njëjtit vend të prodhimit që ndodhet brenda një zone të përcaktuar nga AKVMB-ja.
(8) Asnjë vrojtim zbulimi nuk kërkohet për mbjelljen e bimëve të aneksit I të destinuara për rimbjellë brenda të njëjtit vend prodhimi që ndodhet brenda një zone të përcaktuar nga AKVMB-ja dhe për bimët e renditura në pikat 2 dhe 3, të aneksit I, të destinuara për rimbjellë, kur bimët e vjela do t'u nënshtrohen masave të miratuara zyrtarisht të përmendura në pikën 1 të aneksit II.

UDHËZIM
Nr. 8, datë 21.2.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 23, DATË 20.9.2024, PËR RREGULLAT PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR VENDOSJEN E MASAVE PËR ÇRRËNJOSJE DHE PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË KALBËZIMIT UNAZOR TË PATATES *CLAVIBACTER SEPEDONICUS* (SPIECKERMANN&KOTTHOFF 1914) NOUIOUI *ET AL.* 2018[1]

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 23, datë 20.9.2024, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 6, pika 1 paragrafi i parë zëvendësohet me formulimin si më poshtë:

"1. Bimët e specifikuara, të përcaktuara si të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar në përputhje me shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 5, nuk do të mbillen. Operatorët profesionistë nën mbikëqyrjen e AKVMB-së, garantojnë që bimët e specifikuara të infektuara të shkatërrohen ose të asgjësohen në një mënyrë tjetër, në përputhje me pikën 1, të aneksit V, bashkëlidhur këtij udhëzimi, me kusht që të vërtetohet se nuk ka risk të identifikueshëm të përhapjes së dëmtuesit të specifikuar";

2. Në nenin 3, të pikës 3, pas shkurtesës AKVMB togfjalëshi "i raporton" zëvendësohet me togfjalëshin "ISUV dhe AKU, sipas përgjegjësisë i raportojnë".

3. Aneksi II zëvendësohet me aneksin bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

[1] Ky udhëzim përafron plotësisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2024/2636, e datës 8 tetor 2024, që ndryshon rregulloren zbatuese (BE) 2022/1194 në lidhje me përgjegjësitë e operatorëve profesionistë dhe formatin për të raportuar rezultatet e vrojtimit të *Clavibacter sepedonicus* (Spiecker sepedonicus &9.4. 2018).

ANEKSI II

Formati i vrojtimit referuar në pikën 3, të nenit 3

Formati për paraqitjen e rezultateve të vrojtimeve të kalbëzimit unazor të kryera gjatë vitit kalendarik që i paraprin vitit të raportimit.

Rajoni	Kategoria	Zona e mbjelljes (ha)	Inspektime vizuale të kulturave në rritje					Inspektimet vizuale të lot-eve të zhardhokëve në magazinë [a]			
			Zona e inspektuar vizualisht (ha)	Numri i inspektimeve vizuale [c]	Numri i inspektimeve vizuale ku janë vëzhguar simptoma [ç]	Numri i mostrave simptomatike të marra [d]	Numri i mostrave asimptomatike të marra [d]	Numri i inspektimeve vizuale [c]	Numri i inspektimeve vizuale ku janë vëzhguar simptoma [dh]	Numri i mostrave simptomatike të marra [d]	Numri i mostrave asimptomatike të marra [d]
	Zhardhokët e patates për mbjellje [b]										
	Zhardhokët e patates të destinuara të destinuara për t'u mbjellë në vendin e tyre të prodhimit										
	Zhardhokët e patates përveç atyre për mbjellje										

Laboratori	Kategoria	Testet laboratorike në lidhje me inspektimet vizuale të kulturave në rritje			Testet laboratorike në lidhje me inspektimet e grupit të zhardhokëve			Numrat e njoftimit të shpërthimeve të reja të njoftuara, sipas rastit, në përputhje me nenin 15 të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar	Informacione shtese
		Numri i mostrave simptomatike Testuar pozitiv	Numri i mostrave asimptomatike të testuar pozitiv	Numri i inspektimeve vizuale pozitive [e]	Numri i mostrave simptomatike të testuar pozitiv	Numri i mostrave asimptomatike të testuar pozitiv	Numri i lot-eve pozitiv		
	Zhardhokët e patates për mbjellje [b]								

	Zhardhokët e patates të destinuara për t'u mbjellë në vendin e tyre të prodhimit								
	Zhardhokët e patates përveç atyre për mbjellje								

_____.

(a) Të plotësohet vetëm për rezultatet e vrojtimeve të kryera në bimë të specifikuara të rritura dhe të vjela në rajonin përkatës.

(b) Përveç zhardhokëve të destinuara për t'u mbjellë në vendin e tyre të prodhimit.

(c) Duke përfshirë numrin e inspektimeve të shumëfishta vizuale të kryera në të njëjtën fushë ose në të njëjtin lot, sipas rastit.

(ç) Simptomat u gjetën në zhardhokët ose bimët e prera dhe mostrat u morën për testim laboratorik.

(d) Përgatitja e mostrës përshkruhet në aneksin I, pika 4.

(dh) Simptomat u gjetën në zhardhokët e prerë dhe mostrat u morën për testim laboratorik.

(e) Numri total i inspektimeve vizuale për të cilat mostrat u testuan pozitivisht për praninë ose *C. sepedonicus*.

UDHËZIM
Nr. 9, datë 21.2.2025

PËR RREGULLAT PËR MASAT E VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR TË PARANDALUAR HYRJEN DHE PËRHAPJEN BRENDA TERRITORIT TË VENDIT TË BRUMBULLIT TË PATATES *EPITRIX CUCUMERIS* (HARRIS), *EPITRIX SIMILARIS* (GENTNER), *EPITRIX SUBCRINITA* (LEC.) DHE *EPITRIX TUBERIS* (GENTNER)[1]

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, "Për mbrojtjen e bimëve", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1
Dëmtuesit e specifikuar *Epitrix cucumeris* (Harris), *Epitrix papa* sp. n., *Epitrix subcrinita* (Lec.) dhe *Epitrix tuberis* (Gentner)

Epitrix cucumeris (Harris), *Epitrix papa* sp. n., *Epitrix subcrinita* (Lec.) dhe *Epitrix tuberis* (Gentner), më tej "dëmtuesit e specifikuar", nuk lejohen të hyjnë ose përhapen brenda territorit të vendit.

Neni 2
Hyrja e zhardhokëve të patates brenda territorit të vendit

1. Zhardhokët e *Solanum tuberosum* L., duke përfshirë ato të destinuara për mbjellje, në vijim "zhardhokët e patates", me origjinë nga vendet e tjera ku dihet se janë të pranishëm një ose më shumë nga dëmtuesit e specifikuar, mund të hyjnë në territorin e vendit vetëm nëse ata plotësojnë kërkesat specifike të importit, siç përcaktohet në pikën 1, të seksionit 1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkesat me zhardhokë patateje në import inspektohen nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) në përputhje me procedurat e pikës 5, të seksionit 1, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Neni 3
Lëvizja e zhardhokëve të patates brenda territorit të vendit

1. Zhardhokët e patates me origjinë nga zonat e shënuara brenda territorit të vendit, të krijuar në përputhje me nenin 7 të këtij udhëzimi, të ambalazhuar brenda këtyre zonave ose në objektet e përmendura në nenin 5 të këtij udhëzimi, mund të lëvizin brenda territorit të vendit vetëm nëse plotësojnë kushtet, siç përcaktohet në pikën 1, të seksionit 2, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Zhardhokët e patates me origjinë nga një zonë e shënuar, mund të lëvizin nga kjo zonë e shënuar në një objekt ambalazhimi që plotëson kërkesat e nenit 5 të këtij udhëzimi, i cili është në afërsi të kësaj zone të përcaktuar, me kusht që të plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 2, të seksionit 2, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Zhardhokët e patates mund të ruhen në atë objekt.

Në rastin e nënparagrafit të dytë të kësaj pike, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) kryen veprimet e mëposhtme:

a) monitorim intensiv i pranisë së dëmtuesit të specifikuar dhe i simptomave të infektimit nga ky dëmtues në zhardhokët e patates, nëpërmjet inspektimeve në kohën e përshtatshme mbi bimët e patates dhe sipas rastit, bimët e tjera bujtëse, duke përfshirë fushat ku këto bimë rriten, brenda një rrezeje prej 100 m të objektit të ambalazhimit;

b) aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me kërcënimin e dëmtuesve të specifikuar dhe masat e miratuara për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda territorit të vendit në afërsi të objektit të ambalazhimit.

2. Zhardhokët e patates, që hyjnë brenda territorit të vendit në përputhje me nenin 2, të këtij udhëzimi, nga vendet e tjera ku dihet se janë të pranishëm një ose më shumë nga dëmtuesit e specifikuar, mund të lëvizin brenda territorit të vendit vetëm nëse plotësojnë kushtet, siç përcaktohet në pikën 3, të seksionit 2, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

[1] Ky udhëzim përafron pjesërisht vendimin zbatues të Komisionit 2012/270/BE, të datës 16 maj 2012, në lidhje me masat emergjente për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda Unionit të *Epitrix cucumeris* (Harris), *Epitrix papa* sp. n., *Epitrix subcrinita* (Lec.) dhe *Epitrix tuberis* (Gentner).

Neni 4
Kërkesat në lidhje me mjetet e transportit, ambalazhin, makineritë dhe mbeturinat e dheut

1. AKVMB-ja siguron që çdo mjet transporti dhe ambalazh, që është përdorur për transportimin e zhardhokëve të patates me origjinë në një zonë të shënuar përpara plotësimit të kërkesës së shkronjës "b", të pikës 1, të seksionit 2, të aneksit I, bashkëlidhur këtij udhëzimi, është dezinfektuar dhe pastruar në mënyrën e duhur në rastet e mëposhtme:

a) përpara se të lëvizin jashtë zonës së shënuar; dhe

b) përpara se të largohen nga një mjedis ambalazhimi, siç përmendet në nënparagrafin e dytë të pikës 1, të nenit, 3 të këtij udhëzimi.

2. AKVMB-ja siguron që makineritë e përdorura për të trajtuar zhardhokët e patates të përmendura në paragrafin 1 në një ambient ambalazhimi të përmendur në nënparagrafin e dytë të pikës 1, të nenit 3, të dezinfektohen dhe pastrohen në mënyrën e duhur pas çdo përdorimi.

3. AKVMB-ja siguron që mbeturinat e dheut ose materialet e tjera mbeturinash, që rezulton nga përmbushja e kërkesave të pikës 1, të nenit 3 dhe paragrafëve 1 dhe 2, të këtij neni, asgjësohen në një mënyrë të tillë që të sigurohet që dëmtuesit e specifikuar nuk mund të vendosen ose të përhapen jashtë një zone të shënuar.

Neni 5
Kërkesat në lidhje me objektet e ambalazhimit të vendosura jashtë zonave të shënuara

Objektet e ambalazhimit, të vendosura jashtë zonave të shënuara për këtë dëmtues të specifikuar dhe për trajtimin e zhardhokëve të patates me origjinë nga zona të shënuara, siç përmendet në nënparagrafin e dytë të pikës 1, të nenit 3, duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) janë të autorizuar nga AKVMB-ja për të ambalazhuar zhardhokët e patates me origjinë nga një zonë e shënuar; dhe

b) ruajnë, për një vit nga momenti i mbërritjes së zhardhokëve të patates në atë mjedis, të dhënat e zhardhokëve të patates të trajtuara, të cilat e kanë origjinën në zona të shënuara.

Neni 6
Vrojtimet dhe njoftimet në lidhje me dëmtuesit e specifikuar

1. AKVMB-ja kryen vrojtime zyrtare vjetore për praninë e dëmtuesve të specifikuar dhe simptomat e infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates dhe, sipas rastit, në bimë bujtëse të tjera, duke përfshirë fushat ku rriten zhardhokët e patates.

AKVMB-ja do t'i njoftojë strukturës përgjegjëse të mbrojtjes së bimëve (SPMB-së) rezultatet e këtyre vrojtimeve deri më 30 prill të çdo viti.

2. Operatorët profesionistë duhet të njoftojnë menjëherë tek AKVMB-ja për çdo prani ose prani e dyshuar e një dëmtuesi të specifikuar, ose e simptomave të infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates.

Neni 7
Zonat e shënuara dhe masat që duhen marrë në këto zona

1. Kur rezultatet e vrojtimeve, të përmendura në pikën 1, të nenit 4, ose të dhëna të tjera, konfirmojnë praninë e një dëmtuesi të specifikuar ose të simptomave të infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates në një zonë, krijohet pa vonesë një zonë e shënuar e përbërë nga një zonë e infektuar dhe një zonë sigurie, siç përcaktohet në seksionin 1, të aneksit II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

AKVMB-ja merr masa, e përcaktuar në seksionin 2, të aneksit II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Në rastet e masave të marra në përputhje me pikën 1, AKVMB-ja publikon në faqen zyrtare listën e zonave të shënuara, informacionin për përcaktimin e tyre, duke përfshirë hartat që tregojnë vendndodhjen e tyre dhe një përshkrim të masave të zbatuara në ato zona të shënuara.

Neni 8
Dispozitat përfundimtare dhe hyrja në fuqi

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 janar 2025.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

ANEKSI I

Seksioni 1
Kërkesat specifike për hyrje brenda territorit të vendit

1. Pa cenuar dispozitat e përcaktuara në urdhrin nr. 113, datë 15.3.2022, "Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve", të ndryshuar, zhardhokët e patates me origjinë nga vendet e tjera ku dihet se janë të pranishëm një ose më shumë nga dëmtuesit e specifikuar, duhet të shoqërohen nga një certifikatë fitosanitare, siç përmendet në pikën 1, të nenit 19, të urdhrit nr. 113, datë 15.3.2022, "Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve", të ndryshuar, e cila përfshin nën titullin "Deklaratë shtesë" informacionin e përcaktuar në pikat 2 dhe 3.

2. Certifikata fitosanitare duhet të përfshijë informacionin në shkronjën "a" ose "b":

a) zhardhokët e patates janë rritur në një zonë pa dëmtues të krijuar nga organizata kombëtare për mbrojtjen e bimëve në përputhje me standardet ndërkombëtare për masat fitosanitare përkatëse; ose

b) zhardhokët e patates janë larë ose pastruar, në mënyrë që të mos ketë mbetur më shumë se 0,1% e dheut ose i janë nënshtruar një metode ekuivalente të aplikuar posaçërisht për të arritur të njëjtin rezultat dhe për të hequr dëmtuesit e specifikuar dhe për të siguruar se nuk ekziston risk i përhapjes së dëmtuesve të specifikuar.

3. Certifikata fitosanitare, duhet të përmbajë sa vijon:

a) përfshin informacionin se zhardhokët e patates janë gjetur të pastra nga dëmtuesit e specifikuar dhe nga simptomat e infektimit nga këta dëmtues, në zhardhokët e patates dhe nuk përmbajnë më shumë se 0,1% të dheut, në një ekzaminim zyrtar i kryer menjëherë përpara eksportit;

b) përfshin informacionin që materiali i ambalazhimit në të cilin importohen zhardhokët e patates është i pastër.

4. Kur jepet informacioni i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 2, emri i zonës së mbrojtur nga dëmtuesit do të përmendet nën titullin "Vendi i origjinës", për këta dëmtues të specifikuar.

5. Zhardhokët e patates për hyrje brenda territorit të vendit në përputhje me pikat 1 deri në 4 do të inspektohen në pikën e inspektimit kufitar (PIK) për të konfirmuar se ato plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga pikat 1 deri në 4 të këtij seksioni.

Seksioni 2
Kushtet për lëvizjen

1. Zhardhokët e patates me origjinë nga zonat e shënuara brenda territorit të vendit mund të lëvizin nga këto zona në zona jo të shënuara vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) zhardhokët e patates janë rritur në një vend të regjistruar prodhimi në përputhje me udhëzimin nr. 10, datë 28.4.2023, "Për formatin, kriteret dhe procedurat e regjistrimit të operatorëve profesionistë";

b) zhardhokët e patates janë larë ose pastruar, në mënyrë që të mos ketë mbetur më shumë se 0,1% e dheut ose i janë nënshtruar një metode ekuivalente të aplikuar posaçërisht për të arritur të njëjtin rezultat dhe për të hequr dëmtuesit e specifikuar dhe për të siguruar që nuk ka risk të përhapjes së dëmtuesve të specifikuar;

c) materiali i ambalazhimit në të cilin lëvizen zhardhokët e patates është i pastër; dhe

ç) zhardhokët e patates shoqërohen nga një pasaportë bimore e përgatitur dhe e lëshuar në përputhje me urdhrin nr. 274, datë 5.5.2023, "Për procedurën, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një operator për t'u miratuar për lëshimin e pasaportës bimore, si dhe rastet e heqjes së miratimit".

2. Për lëvizjen e zhardhokëve të patates në objektin e ambalazhimit, siç përmendet në nënparagrafin e dytë të pikës 1, të nenit 3, përveç shkronjës "a", të pikës 1, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) zhardhokët e patates janë rritur në fusha që i janë nënshtruar trajtimeve me insekticide kundër dëmtuesve të specifikuar në kohë të përshtatshme gjatë sezonit të rritjes;

b) janë kryer inspektime zyrtare para vjeljes, në kohën e duhur, në fushë dhe nuk është zbuluar asnjë dëmtues i specifikuar;

c) prodhuesi ka njoftuar paraprakisht AKVMB-në për qëllimin e tij për të lëvizur zhardhokët e patates në përputhje me këtë pikë dhe për datën e lëvizjes;

ç) zhardhokët e patates transportohen në objektin e ambalazhimit në automjete të mbyllura ose në ambalazhe të mbyllura dhe të pastra, në

mënyrë të tillë që të sigurohet që dëmtuesit e specifikuar të mos mund të largohen ose të përhapen;

d) gjatë transportit të tyre në objektin e ambalazhimit, zhardhokët e patates shoqërohen nga një dokument që identifikon origjinën dhe destinacionin e tyre; dhe

e) menjëherë pas mbërritjes në ambientet e ambalazhimit, zhardhokët e patates i nënshtrohen trajtimit të përshkruar në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij seksioni.

3. Zhardhokët e patates të hyra në territorin e vendit në përputhje me seksionin 1 nga vendet e tjera ku dihet se një ose më shumë nga dëmtuesit e specifikuar janë të pranishëm, mund të zhvendosen brenda vendit vetëm nëse shoqërohen me pasaportë bimore të përmendur në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij seksioni.

ANEKSI II
ZONAT E SHËNUARA DHE MASAT NË PËRPUTHJE ME NENIN 5

Seksioni 1
Krijimi i zonave të shënuara

1. Zonat e shënuara përbëhen nga këto zona:

a) një zonë e infektuar, që përfshin të paktën fushat ku është konfirmuar prania e dëmtuesit të specifikuar ose janë konfirmuar simptomat e infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates, si dhe në fushat ku janë rritur zhardhokët e infektuar të patates; dhe

b) një zonë sigurie me një gjerësi prej të paktën 500 m nga kufijtë e zonës së infektuar; kur një pjesë e një fushe është brenda kësaj gjerësie, e gjithë fusha do të jetë pjesë e kësaj zone sigurie.

2. Në rastet kur disa zona sigurie mbivendosen ose janë gjeografikisht të afërta, do të krijohet një zonë e shënuar, e cila përfshin sipërfaqen e mbuluar me zonat e shënuara përkatëse dhe zonat ndërmjet tyre.

3. Kur përcaktohen zona e infektuar dhe zona e sigurisë, AKVMB-ja marr parasysh elementet e mëposhtme: biologjinë e dëmtuesve të specifikuar, shkallën e infektimit, shpërndarjen e bimëve bujtëse, të dhënat e vendosjes së dëmtuesve të specifikuar dhe kapacitetin e dëmtuesve të specifikuar për përhapen në mënyrë natyrale.

4. Nëse prania e një dëmtuesi të specifikuar ose simptomave të infektimit nga ky dëmtues i zhardhokëve të patates konfirmohet jashtë zonës së infektuar, kufiri i zonës së infektuar dhe zonës së sigurisë rishikohet dhe ndryshohet në përputhje me procedurat ligjore.

5. Për sa i përket një zone të shënuar, bazuar në vrojtimet e përmendura në pikën 1, të nenit 4, as dëmtuesit e specifikuar dhe as simptomat e infektimit nga ky dëmtues në zhardhokët e patates nuk janë hasur për një periudhë prej dy vjetësh, AKVMB-ja në bashkëpunim me SPMB-në konfirmon sipas procedurave ligjore se ky dëmtues nuk është më i pranishëm në atë zonë dhe se zona shfuqizohet si zonë e shënuar.

Seksioni 2
Masat në zonat e shënuara, siç parashikohet në nënparagrafin e dytë, të pikës 1, të nenit 5

Masat e marra nga AKMVB-ja në zonat e shënuara përfshijnë të paktën sa vijon:

1. Masat për çrrënjosjen ose kontrollin e dëmtuesve të specifikuar, duke përfshirë trajtimet dhe dezinfektimet, si dhe ndalimin e mbjelljes së bimëve bujtëse kur është e nevojshme;

2. Monitorim intensiv për praninë e dëmtuesve të specifikuar ose të simptomave të infektimit nga këta dëmtues në zhardhokët e patates nëpërmjet inspektimeve të duhura;

3. Mbikëqyrja e lëvizjes së zhardhokëve të patates jashtë zonave të shënuara.

URDHËR
Nr. 159, datë 21.2.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E UKRAINËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	*Ndarja administrative e nivelit të dytë*	*Ndarja administrative e nivelit të tretë*
Chernihiv	*Ripkyns'kyi**	
Chernihiv	*Chernivets'ka**	
Chernihiv	*Nizhyns'kyi**	
Chernihiv	*Kozelets'kyi**	
Chernihiv	*Pryluts'kyi**	
Chernihiv	*Nosivs'kyi**	
Chernihiv	*Sribnians'kyi**	
Chernihiv	*Mens'kyi**	
Chernivtsi	*Hlybots'kyi**	
Chernivtsi	*Sokyrians'kyi**	
Chernivtsi	*Zastavnets'kyi**	
Cherkasy	*Smilians'kyi**	
Cherkasy	*Cherkas'kyi**	
Donets'k	*Slovians'kyi**	
Donets'k	*Krasnolymans'kyi**	
Donets'k	*Velykonovosilkivs'kyi**	
Kharkiv	*Krasnokuts'kyi**	
Kharkiv	*Novovodolaz'kyi**	
Kharkiv	*Valkivs'kyi**	
Kiev	*Obukhivs'kyi**	
Kiev	*Vyshhorods'kyi**	
Kiev	*Boryspil's'ka**	
Kiev	*Ivankivs'kyi**	
Kiev	*Holosiivs'kyi**	
Kiev	*Rokytnians'kyi**	
Kiev	*Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi**	
Kiev	*Bilotserkivs'kyi**	
Kiev	*Baryshivs'kyi**	
Kiev	*Kaharlyts'kyi**	
Kiev	*Iahotyns'kyi**	
Kiev	*Tarashchans'kyi**	
Kiev	*Myronivs'kyi**	
Kirovohrad	*Dobrovelychkivs'kyi**	
Kirovohrad	*Kirovohrads'kyi**	
Kirovohrad	*Novomyrhorods'kyi**	
Kirovohrad	*Novoukrans'ky**	
Kirovohrad	*Oleksandriis'kyi**	
Kirovohrad	*Petrivs'kyi**	
Kirovohrad	*Svitlovods'kyi**	
Kirovohrad	*Znamians'kyi**	
Zhytomyr	*Chudnivs'kyi**	
Zhytomyr	*Zhytomyrs'ka**	
Zhytomyr	*Berdychivs'kyi**	
Volyn	*Volodymyr-Volyns'kyi**	
Kherson	*Beryslavs'kyi**	
Kherson	*Novovorontsovs'kyi**	
Kherson	***Velykooleksandrivs'kyi****	
Mykolayi	*Mykolaivs'kyi**	
Mykolayiv	*Berezans'kyi**	
Mykolayi	*Bereznehuvats'kyi**	
Mykolayiv	*Kazanetskyi**	
Mykolayiv	*Kryvoozers'kyi**	
Mykolayiv	*Novobuz'kyi**	
Mykolayiv	*Vradiivs'kyi**	
Odessa	*Kotovs'kyi**	
Odessa	*Izmail's'ka**	
Odessa	*Bilhorod-Dnistrovs'kyi**	
Odessa	*Biliaivs'kyi**	
Poltava	*Hlobyns'kyi**	
Poltava	*Kobeliats'kyi**	
Poltava	*Kozel'shchyns'kyi**	
Poltava	*Poltavs'kyi**	
Poltava	*Semenivs'kyi**	
Ivano-Frankivs'k	*Kolomyis'kyi**	
Ivano-Frankivs'k	*Rozhniativs'kyi**	
Sumy	*Konotops'kyi**	
Sumy	*Krolevets'kyi**	
Sumy	*Lebedyns'kyi**	
Sumy	*Nedryhailivs'kyi**	
Sumy	*Romens'kyi**	
Sumy	*Sums'kyi**	
Vinnytsya	*Bershads'kyi**	
Vinnytsya	*Iampil's'kyi**	
Vinnytsya	*Illinets'kyi**	
Vinnytsya	*Lypovets'kyi**	
Zaporizhzhya	*Orikhivs'kyi**	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

